



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI

Nr. 4153 Prot.  
13

Tiranë, më 4.12.2020

AUTORIZIM

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 9, të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 413 datë 25.11.2020, “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Presidenti i Republikës”, si dhe Vendimit nr. 404 datë 25.11.2019, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””,

AUTORIZOJ:

1. Shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (2021) të realizohet nën drejtimin e Drejtorit të Kabinetit të Presidentit të Republikës zoti Edmond Panariti dhe/ose zonja Ornela Zonja me detyrë Sekretare e Përgjithshme e Institucionit të Presidentit të Republikës.
2. Kryerjen e drejtimit dhe moderimit të procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (2021) në datën 4 dhjetor 2020, ora 11:00, nga: Zoti **Bledar Dervishaj**, Këshilltar i Presidentit të Republikës për Çështjet Ligjore.
3. Tërheqjen e goglave për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga anëtarë të Sekretariatit Teknik dhe/ose, përkatësisht sipas ftesës së drejtuesit e moderuesit të procedurës, nga përfaqësuesit e institucioneve të ftuar për të qënë të pranishëm si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit.
4. Personi i autorizuar si më sipër të ndjekë rregullat e detajuara për organizimin e procedurës së hedhjes së shortit, të përcaktuara në Vendimin nr. 404 datë 25.11.2019, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””.
5. Shpallja e rezultatit të shortit nënshkruhet dhe shpallet nga zonja Ornela Zonja me detyrë Sekretare e Përgjithshme e Institucionit të Presidentit të Republikës.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
ILIR META

